

INFORMATIKA E BIZNESIT

Hyrje në informatikën e biznesit

2

- Nga rrjedh fjala Informatike?
- **L'INFORMATIQUE=L'INFORmation+L'autoMATIQ
UE**
(Filip Drejfus në vitin 1962, ne France)
përkatsisht :
- **INFORMATIKA=INFORmata + autoMATIKA**
burime të tjera si :
INFORMATIKA = INFORMATION + MATEMATIK

Ç'është informatika?

3

Informatika është shkencë e cila bënë:

- mbledhjen,
- përpunimin,
- depozitimin,
- bartjen (transmetimin) dhe
- shfrytëzimin e të dhënave/informatave me ndihmën e pajisjeve teknike për përpunimin e të dhënave në kuadër të nje sistemi të caktuar informativ.

- Historikisht informatika si shkencë është zhvilluar nga matematika kurse zhvillimi i sistemeve të para llogaritare zanafillën e kanë në elektroteknikë dhe teknikën e informacionit.
- Sidoqofte kompjuterët paraqesin vetëm një medium të informatikës për zbatim praktik të koncepteve teorike.

- Kërkesa gjithnjë e në rritje për informacione, sidomos, informacione më të përbëra, si dhe shpenzimet e larta të pranimit të tyre në formë natyrore (joelektronike), krijoi kërkesat për zhvillim të shpejtë të kompjuterëve.
- Informatika përjetoj zhvillim të fuqishëm në vitet e gjashtëdhjeta të shek XX. Suksesi që pati e çoi në vetë majën e të gjitha degëve të tjera industriale.

Informatika sot është shkencë mjaft e zgjeruar dhe e diversifikuar në disa lëmi, e ndër më të zëshmet janë:

- Teoria e Algoritmeve,
- Struktura e të dhënave,
- Përpunimi i të dhënave,
- Bazat e të dhënave,
- Arqitektura e kompjuterëve,
- Kodet dhe kodimet,
- Logjika kompjuterike,
- Komunikimi dhe lidhjet,
- Udhëheqja e proceseve, etj.

Rëndësia e Informatikës

7

- Informatika i ka mbuluar pothuajse të gjitha sferat e jetës moderne, dhe posaçërisht kjo është mundësuar nëpërmjet ndikimit enormë të Internetit.
- Lidhja në rrjeta të ndryshme lokale dhe posaçërisht ato internacionale solli revolucion në telekomunikacion dhe në përpunimin e të dhënave/informatave në ndërmarrje, në Logjistikë, Media por edhe në Amvisritë private.

Degët/Disiplinat e Informatikës

8

Informatika ndahet në sfera apo fusha dhe atë në:

1. Informatikën teorike
2. Informatikën praktike
3. Informatikën teknike

Informatika teorike -ka të bëjë në rend të parë me aspekte të ndryshme të Algoritmeve dhe mund të trajtohet si bazë për disiplinat tjera të informatikës.

- **Informatika praktike** – ka të bëjë me zgjidhjen e problemeve konkrete të informatikës dhe posaçërisht me zhvillimin e programeve kompjuterike në të ashtuquajturën teknikë softverike.
- Ofron koncepte themelore për zgjedhjen e detyrave/problemeve standarde, p.sh, memorimi dhe qeverisja e informacioneve nëpërmjet strukturave të të dhënave.
- Informatika praktike furnizon apo siguron vegla për zhvillim të softverit.

- **Informatika teknike** - mirret me aspektet apo bazat hardverike të informatikës si psh. Arkitektura e kompjuterëve, teknika e mikroprocesorëve, sistemet e shpërndara etj.,dhe paraqet lidhje (*connecting link*) me elektroteknikën.

Aplikimi i informatikës në fusha të ndryshme të jetës së përdishme si dhe në sfera (profesionale) të ndryshme si psh. në Informatikën e biznesit/afariste, informatikën medicinale e tj. njihen me emrin Informatika Aplikative/Aplikuar.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, Information and communication technologies

11

(ICT)

- Paraqet term gjenerik (të pergjithshëm) i cili përfshin të gjitha mjetet teknike për përpunimin e informacionit dhe komunikimit. Termi ka fituar popullaritet pjesërisht për shkak të konvergjencës së teknologjisë së informacionit (IT) dhe teknologjive të telekomunikacionit.
- ICT përcakton një gamë të gjerë të teknologjive, duke përfshirë metodat për komunikim (protokollet e komunikimit, teknikat e transmetimit, pajisjet e komunikimit, mediat (komunikim)), si dhe teknikat për memorim dhe përpunimin e informacionit.

- Termi **Teknologji** (nga greqishtja = τεχνολογία) - dituria që ka të bëjë me prodhim ose/dhe përpunim, e që fillimisht nënkuptonte diturinë apo shkencën e një teknike.
- Në përdorim bashkëkohore, termi -**Teknologji** shpesh përdoret si sinonim për **Teknikë**.
- Termi **Teknikë** paraqet një metodë apo mënyrë që do të përdoret për të arritur një rezultat të veçantë.
- Termi **Teknologji** paraqet njohjen e kësaj **Teknike** (Si funksionon ajo? Cilat janë përvojat, rreziqet dhe mundësitë që i ofron ajo").

Në Information Technology Association of America (ITAA) është definuar si:

“ the study, design, development, implementation, support or management of computer-based information systems, particularly software applications and computer hardware”

TI- ka të bëjë me shfrytëzimin e kompjuterëve dhe softverin e kompjuterëve për konvertimin, ruajtjen, memorimin, procesimin, bartjen dhe rikthimin e sigurt të informatave.

Informatika e Biznesit

14

- Informatika e Biznesit është një disiplinë në zhvillim e sipër që kombinon aspekte të ndryshme të Menaxhimit të Biznesit, të Teknologjisë së Informacionit, dhe Informatikës.
- Qëllimi i Informatikës së Biznesit është që të integroj shkencat kompjuterike dhe administrimin e biznesit në një fushë.

- Kjo disiplinë e veçantë origjinën e ka në Gjermani, dhe popullariteti i saj është përhapur në Evropën qendrore. Shumë institucione të arsimit të lartë, kryesisht në Evropë, ofrojnë shkollim 4 vjeçar të informatikës e biznesit.
- Kjo është një fushë që ndryshon dhe zhvillohet me shpejtësi, dhe mësimet e saja për këtë arsye duhet të rishikohen dhe rishqyrtohen vazhdimisht.

Pra, Informatika e Biznesit (BI) është një disiplinë që kombinon Teknologjinë e Informacionit (IT), Informatikën dhe Konceptet e Menaxhimit.

Disiplina e Informatikës së Biznesit u krijua në Gjermani, nga koncepti “Wirtschaftsinformatik”.

- Ajo është themeluar, si një disiplinë e suksesshme akademike, duke përfshirë, programet bachelor, master dhe programet e diplomave në Austri, Bullgari, Francë, Gjermani, Irlandë, Hollandë, Zvicër dhe në një numër në rritje të vendeve të tjera evropiane, si dhe në Australi.

Informatika e Biznesit integron në një fushë elementet themelore nga **Administrata e Biznesit, Sistemet e Informacionit dhe Shkenca Kompjuterike.** (Wikipedia)

Informatika e Biznesit është padyshim Interdisciplinare, dhe mund të tërheqë në një numër të disipinave të ndryshme.

Teorikisht, qëllimi i informatikës së biznesit është për të tejkaluar hendekun mes të teknologjisë së informacionit dhe proceseve e biznesore.

- Pra, si permbledhje mund te themi se informatika e biznesit mbështetet në teknologjinë kompjuterike dhe telekomunikuese, dhe mundëson një qasje të re të punës, zhvillimit dhe jetës në përgjithësi.
- Ajo ndryshon në tërësi mënyrën e punës, gjatë së cilës, kultin e punës fizike, e zëvendëson me dijeni dhe automatizim të punës. Zbatimi i informatikës biznesore është posaçërisht i rëndësishëm për drejtimin e sistemeve biznesore dhe automatizimin e tyre.

Modelet, Kompjuterat dhe Sistemet e kompjuterave

19

- Bejne te mundur ne menyre te vazhdueshme qe organizatat te permiresojne menyren e berjes se biznesit.
- Identifikimi i tipeve te modeleve dhe spjegimi pse perdoren ato.
- Pershkrimi i karakteristikave te komponenteve te sistemit te informacionit (SI) dhe percaktimi i tyre.

Sistemi i Informacionit

20

- Një grup i komponentëve të ndërlidhura që mbledhin, manipulojnë dhe shpërndajnë të dhënat dhe informacionet dhe japin komente(feedback) për të përmbushur një objektiv apo një qëllim.
- **Shembuj:** Sistemet e Rezervimit për Fluturime; Sisteme për rezervimin e kurseve, etj.

- Ne cdo dite jemi ne raport te pandashem me sistemet e informacionit, psh., bankomatet, skanerat e barcode-eve neper shitore, qasja ne informacione te ndryshme nga interneti, informacione nga touch screens etj.
- Kompjuteret dhe sistemet e informacionit po e ndryshojne ne menyre te vazhdueshme menyren se si organizatat bejne bizneset e tyre.

- Duke e ditur potencialin e **Sistemeve te Informacionit** dhe neqoftese do te dim te shfrytezojme ato, kjo do te na rezultoj ne karrier me te sukseshme personale dhe cilesia e jeteses do te jete me e larte!

Qëllimi i përpunimit të Informacioneve

23

- Racionalizimi apo kursimet e shpenzimeve
- Trajtimin e sasive të mëdha të të dhënave
- Përhshpejtimin e proceseve biznesore
- Përmirësimi i cilësisë dhe i shërbimeve
- Mbështetje të Planifikimit, Menaxhimit dhe Kontrollit ---Llogaritje të gjëra (Extensive) dhe të komplikuar
- Mundësimi i formave të reja të organizimit.

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE DHE RESURSET KRYESORE TË SISTEMIT INFORMATIV

24

- Disa të dhënave nuk mund t'ju qasemi drejtpërdrejtë.
- Kështu, për shembull, nota mesatare e një nxënësi përmbahet në tërësinë e të gjitha notave të veçanta të tij dhe për të ardhur deri te ajo, është e domosdoshme të kryhen disa operacione të caktuara llogaritëse, të përpiqet, të harxhohet një energji të caktuar.
- Ashtu siç është e nevojshme që minerali I hekurit të përpunohet që të arrihet deri te hekuri, ashtu shpesh herë është e nevojshme që të dhënat "bazë" të përpunohen me qëllim që të fitohen të dhëna ose informata të tjera.
- Aktiviteti i tillë quhet përpunim i të dhënave.

- Përpunimi i të dhënave të ndryshme është një nga aktivitetet më të rëndësishme të secilit njeri biznesor pa marrë parasysh llojin e veprimtarisë që kryen sepse informatat janë të një rëndësie fundamentale në mënyrën bashkohore të punës.
- Gjatë asaj, edhe më tutje mendohet për të gjitha llojet e të dhënave (numerike, tekstuale, figurative, akustike...)
- Përpunimi i të dhënave mund të bëhet në mënyra të ndryshme.

Përpunimi manual

- Eshtë forma më e vjetër e përpunimit të të dhënave, që përdoret edhe sot.
- Paraqitet dhe zhvillohet me zhvillimin e tregtisë dhe shteteve. Është e njohur se si Egjiptianët, Fenikasit, Kinezët, dhe pjestarët e kulturave të tjera i kanë shkruar tekstet dhe numrat.
- Llogaritëset e drurit me toptha përdore mbi 5000 vjet, ndërsa shifrat arabe përdoren në Europë që prej shekullit II-të. Letrat tregtare dhe dokumentet tjera i kanë përpunuar kaligrafët dhe noterët që shkruanin me pendë pate deri në shekullin XIX.

- Në zhvillimin e përpunimit të të dhënave luan rol edhe paraqitja e institucioneve që përcjellnin njoftime me shkrim (posta) dhe për këtë arsye organizojnë komunikacion të rregullt.
- Përpunimi manual i të dhënave ka shumë mangësi: i ngadalshëm, çmim të lartë gabime etj. Për këtë arsye tentohet që ajo të zëvendësohet me mënyra të tjera të përpunimit.

Përpunimi mekanik

28

- **Bazohet në mjete mekanike dhe ndihmëse me të cilat** njeriu drejtpërdrejt i përpunon proceset biznesore.
- Përdoret që nga fundi i shekullit XIX e deri më sot. Megjithëse makina e parë e shkrimit është zbuluar në vitin 1817, prodhimi serik në SHBA filloi në vitin 1874, ndërsa në Europë në vitin 1898.
- Makinat llogaritëse mekanike paraqiten në të njëjtën kohë. Rëndësi të veçantë kanë zbulimet për transmetim të të dhënave me përçues dhe me valë elektromagnetike. Në vitin 1843 është konstruktuar telegrafi (Morse), ndërsa në vitin 1876 është konstruktuar telefoni (Bell) me ç'ka u mundësua transmetimi i të dhënave në largësi.

Përpunimi mekanografik (byroteknik)

29

- Mbështetet në pajisje elektromekanike të cilat procesin e përpunimit e mekanizojnë dhe automatizojnë.
- Pajisjet e këtilla gjejnë përdorim të madh në mes të shekullit të kaluar.
- Për përpunimin e të dhënave numerike shfrytëzohen makina të ndryshme për kontabilitet, për faturim dhe për përpunim elektromekanik të të dhënave.

- Gjatë përpunimit të teksteve shfrytëzohen makina elektromekanike për shkrim, pajisje për adresim, pajisje për kopjim, për detektim, teleprinterët, etj.
- Pajisjet për përpunimin elektromekanik mundësojnë përpunimin programabil në bazë të kartelave të shpuara të cilat në atë kohë kanë qenë medium ideal për memorimin e të dhënave dhe informatave.

Përpunimi elektronik i të dhënave

31

- Mbështetet në zbatimin e kompjuterëve elektronik.
- Gjatë kësaj, të dhënat e formave të ndryshme (shkronjë, zë, figurë, etj.), duhen të paraqiten në formë të përshtatshme për përpunim elektronik.
- Kjo do të thotë se të gjithë të dhënat shëndrohen në formë numerike (vargje numrash, gjegjësisht vargje njëshash dhe zerosh), dhe vetë udhëzimet për përpunim (programet), janë gjithashtu në formë numerike.

- Për transformimin e të dhënave në formë të këtillë ekzistojnë pajisje speciale (skanerë, mikrofonë, etj).
- Kompjuterët e krahasojnë përpunimin e të dhënave në bazë të një plani të punës të pregaditur që më parë të ashtëquajtur program.
- Për ndryshim nga pajisjet elektromekanike që gjithashtu mund të punojnë me një plan të dhënë paraprakisht, kompjuterët mund të sjellin vendime në bazë të të dhënave që i përpunojnë, të sjellin vendim mbi të cilin do të vazhdojnë përpunimin nga disa mënyra të ndryshme të mundshme (të ofruara).

